



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
ELBASAN**

BASHKIA MA
Z. e Protok
Nr. 1720 Prot.....
Date 5-5-2020 Nenshkrimi

Nr 3701 regj

- Wj. Ad. Libonik.
- Drg. Juf. Pultika ✓
04-05-2020

date 29.04.2020

Nr: 510 prot
Data: 04.05.2020

SHPALLJE

Prane kesaj gjykate eshte gjykuar ceshtja penale e vecante Nr 3701 date 18.02.2020 qe I perket prok objekti; pushim ceshtje

Sipas deftese se komunikimit qe ndodhet ne dosje Nefajet Pajo eshte larguar

Hartohet kjo shpallje e cila ze vendin e komunikimit per Nefajet Pajo per vendimin penal Nr.3701 date 18.02.2020 hartohet ne tre kopje nje ne dosje gjyqesore e dyta tek porta e gjykates dhe e treta afishohet ne adresen qe kemi ne dosje Fshati Kloce ,Libonik Korce

**K/SEKRETARE
LINDITA CELA**

Bashkia Korce

Njesise Administrative qe perfshin fshati Libonik Korce

Bashkelidhur shpalljes po ju degojme per vendimin penal te vecante nr 3701, date 18.02 .2020

Kerkojme nga ana juaj ten a konfirmoni dhe dergoni daten e afishimit te kesaj shpallje.

**K/SEKRETARE
LINDITA CELA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

NR.I REGJ. THEMELTAR 3701
DATA E REGJ. 26.12.2019

NR. I VENDIMIT 3701
DATA 18.02.2020

VENDIM
“ NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e përbërënga:

GJYQTARE: Miranda KONICA

Asistuar prej sekretares Vojsava Gjini, në Elbasan, sot më dt **18.02.2020**, mori në shqyrtim në seance paraprake çështjen që l përket;

K E R K U E S : Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përfaqesuar në gjykim nga prokurore Pranvera Stafa- nuk u paraqit.

Viktima(i demtuar nga vepra penale) : Nefajet Pajo banues ne fshatin Kloce Libonik Korce-nuk u be i mundur njoftimi pasi rezultoi i panjohur

O B J E K T I: Kërkesë për pushimin e çështjes.

BAZA LIGJORE: Nenet 329/a; 328/1 germa d të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seance paraprake, gjykata pasi shqyrtoi dhe administroi provat shkresore të ndodhura në dosje,

VEREN

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan është paraqitur për shqyrtim kërkesa për Pushimin e çështjes penale Nr.1198/2009, për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

Ne referim të percaktimeve ligjore të nenit 329/a dhe 329/b të K.K.Pr.Penal nga gjykata u thirr për të marrë pjesë në seancë paraprake në çështjen e paraqitur nga organi procedurës me objekt pushimin e çështjes referuar nenit 328 pika 1 germa D dhe nenit 66 germa ç të K.Penal, dhe **viktima(i demtuar nga vepra penale) Nefajet Pajo** gjykim i cili u zhvillua pa praninë e tyre.

Nga aktet e fashikullit të hetimit të procedimit penal nr 1198/2009 rezultoi se : Me dt 03.10.2009 shtetesja Nefajet Pajo kishte ardhur për vizite tek motra e saj Myrvete Muca në qytetin e Elbasanit. Gjate dites ajo ka konstatuar se në banesë l është vjedhur cantë në të cilën kishte 100 euro dhe 7000 leke shqiptare dhe disa dokumenta shendetesore dhe leter njoftimi. Në banesën e motres kanë qenë punetore pasi e motra po kryente punime dhe se ajo nuk ka patur dyshime konkrete se nga kush l është vjedhur cantë.Procedimi rezultoi se është regjistruar pa autor.

Me vendimin e date 26.10.2009, nga organi procedures Prokuroria Prane Gjykatës te Rrethit Gjyqesor Elbasan është vendosur: “Pezullimi I procedimit penal”, për arsye se nuk është bërë e mundur zbulimi I autorit .

Sipas relacionit të oficerit të policise gjyqësore mbi studimin e materialit të procedimit penal nr 1198/2009 rezulton se ne lidhje me vjedhjen cantes se shtetases Nefajet Pajo, deri në këtë moment nuk është bërë e mundur gjetja,identifikimi dhe zbulimi I autorit, apo autoreve te vepres penale te “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 Kodit Penal duke sygjieruar dhe pushimin e ceshtjes për shkak të plotësimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale sipas përcaktimeve ligjore të nenit 66/ç KPenal.

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan, ne keto rrethana ka paraqitur per shqyrtim kërkesën për pushimin e çeshtjes penale Nr 1198/2009 për vepren penale të “Vjedhjes ”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, duke referuar ne nenet 328 pika I germa d dhe 329/a të Kodit të Proçedurës Penale dhe nenit 66 germa ç të K.Penal duke parashtruar se , çeshtja penale per kryerjen e vepres penalete “Vjedhjes ”, parashikuar nga neni 134 I Kodit Penal nga momenti I kryerjes të vepres penale dt 03.10.2009 ka kaluar afati ligjor prej 5 vjetesh, I përcaktuar ne nenin 66/ ç te Kodit Penal, dhe vepra penal per te cilen ka nisur procedimi penal ajo e vjedhjes duhet te pushohet pasi ekziston nje shkak qe shuan ate, parashkrimi I ndjekjes penale.

Në shqyrtimin gjyqësor u shqyrtuar dhe u administruan keto akte

- Ne teresi aktet e dosjes penale me Nr. 1198/2009

Arsyetimi i Gjykatës, argumentat juridike, interpretimi i dispozitave të aplikueshme penale e proceduriale penale, analiza e fakteve dhe konkluzionet e Gjykatës.

Dispozita ligjore të zbatueshem në rastin konkret.

Neni 329/a i Kodit të Proçedurës Penale “Kërkesa për pushimin e akuzës ose çeshtjes”, përcakton se :

Paragrafi i parë :“Në përfundim të hetimeve paraprake, kur proçedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi i parë, i nenit 328 të këtij Kodi, prokurori i kerkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzes ose çeshtjes.

Neni 328, pika 1 germa d i Kodit të Proçedurës Penale “Pushimi i akuzës ose çeshtjes”, ndër të tjera përcakton se :

d“Ekziston një shkak që shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë”.

• **Neni 66 I Kodit Penal “Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre”, ndër të tjera përcakton se :**

Nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar :

ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;

Neni 134 I KPenal përcakton:” Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Vepra penale për të cilën është regjistruar proçedim penal, "Vjedhja", parashikuar nga neni 134 Kodit Penal, parashikon si masë denimi, nga *gjobë ose me burgim gjer në tre vjet*".

Gjykata konstaton se nga momenti I kryerjes se veprës penale dt 03.10.2009 deri ne momentin e paraqitjes se kërkeses objekt gjykimi, ka kaluar afati 5 vjecar Brenda të cilit duhet të ushtrohet ndjekja penale, afat ky I përcaktuar në nenin 66 germa "ç" I KPenal.

Institute I parashkrimit të ndjekjes penale I cili parashikohet nga neni 66 I K Penal bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale me të cilin duhet kuptuar ndalimi që ekziston me ligj për të bërë ndjekje penale, në qofte se, nga koha kur është kryer vepra penale, deri në momentin e marrjes si të pandehur të autorit të saj, kanë kaluar afatet e parashikuara në këtë dispozite.

Ky parashikim ligjor ka për qëllimit krijimin e një qëndrueshmërie juridike dhe sociale që mund të arrihet përmes pushimit të ndjekjes penale të atyre fakteve të largët në kohë". Pra koha e ndjekjes penale është një kohë juridike.

Sa me sipër në kushtet kur ekzistojne rrethana që nuk lejojnë vazhdimin e procedimit penal, për këto arsye në mbeshtetje të nenit 328 pika I germa "d" e të K.Pr.Penale dhe nenit 66 germa "ç" e K. Penal, kërkesa e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Elbasan është në përputhje me ligjin procedural, duke u vendosur pushimin e çeshtjes penale Nr. 1198/2009 per vepren penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/ i Kodit Penal, per shkak te ekzistences te shkakut qe shuan vepren penale për shkak te parashkrimit të ndjekjes penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në bazë të nenet 329/a; 329/b vijues te Kodit te Proçedures Penale

VENDOSI

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Pushimin e çeshtjes penale Nr. 1198/2009, për veprën penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, per shkak te parashkrimit te ndjekjes penale.

Shpenzimet gjyqesore në ngarkim të shtetit.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Durrës. Nje kopje vendimi ti komunikohet organit procedues dhe viktimes

U shpall në Elbasan, sot më dt **18.02.2020** .

GJYQTARE
MIRANDA KONICA

Shpenzimet gjyqësore

Shpenzimet gjate hetimit në shumën 1 00 lekë.

Shpenzimet gjate gjykimit në shumën 2 00 lekë.

Shpenzimet gjithsej ne shumen 300 lekë.

SEKRETARE

Vojsava Gjini

Vërtetohet se vendimi mori formë të prerë më datë ____/____/____.

K/SEKRETARE

KANCELAR